
VENDIM
Nr. 9, datë 30.1.2013

**MBI ORGANIGRAMËN E RE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” (NËN
ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM) TË PROPOZUAR PËR MIRATIM ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 21.1.2013 “Për vendosjen e shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.””, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e organigramës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sipas organigramës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e pagës së administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm), në vlerën e 300.000 lekë.

3. Administratori i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm) të hartojë strukturën e përgjithshme të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, duke përcaktuar: numrin total të punonjësve, numrin e punonjësve për secilën drejtori dhe sektor, të drejtat dhe detyrat e çdo punonjësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

